

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GILLODOR			
GILLODOR MUNICIPALITY			
Pranuar		10.01- 2023	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
02	052/01-1982		



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Komiteti Konsultativ për mbrojtje të Ambientit Zhvillim
Ekonomik, shëndetesi dhe Mirëqenie sociale



RAPORT VJETOR PËR VITIN 2022

Fiore Sefiu Shabani

DRENAS 2023

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2022



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Komiteti Konsultativ për mbrojtje të Ambientit Zhvillim
Ekonomik, shëndetesi dhe Mirëqenie sociale



Nr. 052/01-1982 dt. 10.01 2021

Raport vjetor për vitin 2021

Dokumenti në fjalë përban një përmbledhje të mbledhjeve të Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Mjedisit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (më tuje KKZHEMMSHMS) të cilat janë të dokumentuara me fotografi dhe kohën e mbajtjes së mbledhjes, si dhe temat e diskutimit.

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2022

Përmbajtja

Përmbledhje.....	3
------------------	---

Takimet Formale

Takimi I parë.....	5
Takimi I dytë	6
Takimi I Tretë.....	8
Takimi I Katërt.....	10
Takimi I Pestë.....	12
Takimet joformale.....	14
Rezultatet dhe Përfundimi.....	15

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2022

PËRMBLEDHJE

Organizimi I punës së Komiteteve Konsultative rregullohet me UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MAPL) NR.01/2016 PËR PROCEDURËN E THEMELIMIT, ORGANIZIMIN DHE KOMPETENCAT E KOMITETEVE KONSULTATIVE NË KOMUNA.

Aktualisht është viti i katërt që Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Mjedisit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale vepron në kuadër të Komunës së Drenasit. Kemi pasur pesë takime formale dhe takime joformale. Takimet janë thirrur nga kryesuesi e po ashtu edhe nga anëtarët e komitetit. Pjesëmarrës të takimit ishin të gjithë anëtarët e komitetit siç vijon:

1. Fitore Sefiu-Shabani-kryesuese
2. Burim Dvorani-nënkryesues
3. Arbresha Haziri-anëtare
4. Violeta Ipshi-Bujupi-anëtare
5. Basri Gashani-anëtarë

Në takime kemi pasur të ftuar drejtorë të dikastereve të ndryshme që operojnë në komunë ë drenasit, Komitetet Konsultative siq janë ai përbarazi Gjimore, për Arsim Kulturë Rii e Sport si dhe Komitetin për Persona me Aftësi të Kufizuara kemi dhënë rekomandime si gjatë diskutimeve, kemi përcjellë kërkesat e qytetarëve që na I kanë drejtuar përmes faqes tonë në facebook.

Takimet tona gjithmonë janë të hapura edhe për qytetarët të cilët janë njoftuar përmesfaqës sonë e që kjo faqekam më shumë se 1000 njdekës.

Edhe pse pjesëmarrja nga ana e qytetarëve nuk ka qënë e kënaqshme mud të konkludojmë se takimet tona kanë qenëtë frytshme dhe produktive.

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2022

TAKIMET FORMALE

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2022

Takimi I parë

Takimi i parë për vitin 2022 të Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik ,Mbrojtje të Mjedisit , Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale (KKZHEMASHMS) ,u realizu më 21.02.2022.

Më këtë mblëdhe morën pjesë anëtarët e komitetit si:Fitore Sefiu Shabani –kryesuese, Burim Dvorani nën kryesues,dhe anëtarët si: Arbreshë Haziri Hasid dhe Basri Gashani.

Temat e diskutimit në këtë takim ndër të tjerat ishin:

- 1.Raporti vjetor për vitin 2021
- 2.Organizimi I një Tryeze të Rrumbullakët me udhëheqësit e komunës si dhe në bashkëpunim me komitetet tjera konsultative,
- 3.Temat që do të diskutohen nga KKZHESHMS
4. Të tjera.



Në këtë mbledhe caktuam prioritetet të cilat synojmë të arrijmë kete vit duke shtuar rrjetin e bashkëpunimit si me institucionet tona në Drenas e poashtu duke parë mundësinë e bashkëpunimit edhe me komitetet e komunave tjera

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2022

TAKIMI I DYTË

Mbledhja e dytë për vitin 2022 të Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik ,Mbrojtje të Mjedisit , Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale (KKZHEMASHMS) , u mbajt më 15.06.2022.

Në këtë mbledhje morën pjesë anëtarët e komitetit si: Fitore Sefiu Shabani –kryesuese, Burim Dvorani nën kryesues,dhe anëtarët si: Basri Gashani dhe Violeta Ipshi- Bujupi me të ftuar Drejtoreshën për Shërbime Publike dhe Emergjente znj. Lumnie Krapë

Për mbledhjen tonë është informuar edhe opinionin përmes faqes tonë në rrjetin social facebook.

Temat e diskutimit në këtë takim janë kryesisht kërkesa që qytetarët tanë na kanë shënuar në faqen tonë, ndër të tjerat ishin:

- 1.Procesvernali I dt. 21.02.2022
2. Deponitë ilegale që po krijohen nëpër fshatra, inspektimi i tyre,
- 3.Kanalizimi në parkun e Biznesit dhe në fshatin Korroticë e Epërme,
- 4.Sperkatja e hapsirave të gjelbërta në qendrën e qytetit kundër rriqërave,
5. Parregullsitë me kompaninë Pastrimi për largimin e mbeturinave
6. Kanalizimi në Bllokun 8, dhe
7. Fasadimi dhe izolimi i banesave konkretisht Blloqet:I, II, III, IV.
- 8.Rruga Asllan Fazliu pa ndriqim që disa muaj.



RAPORT VJETOR PËR VITIN 2022

Ne këtë mbledhje diskutuam me Drejtoreshen dhe morem këto përgjigje :

-Deponit Ilagale janë një shqetesim I madh tash e dy vitet e fundit ,mirpo Komuna nuk ka buxhet te mjaftushem dhe kjo varet nga Niveli qendror po ashtu nje problem tjeter është edhe mungesa e inspektoreve.

-Pika tjeter ishte Kanalizimi në Parkun e Biznesit dhe në fshatin Korroticë e Epërme, ,ku u informuam që sa I përket kësaj pyetje te parashtruar nga qytetaret e Komunes tonë , kjo është Kompetenc nga Ministria ,pra nga niveli qendror.

-Sa i përket sperkatjes së Ambientit kunder rriqërave , nuk ka pas asnje rast dhe që nuk ka ndonje projekt ,mirpo informimi bëhet nga Instituti,Kombetarë për Shëndetësi Publike për te ndërrmar pastaj Drejtoria masat e nevojshme .

-Rreth parregullësive të Kompanis PASTRIMI u tha që është bërë kërkes për Kompani Publike .

-Rreth Kanalizimit ne bllokun 8 drejtoria nuk ka kompetenca ,pra varet nga Operatori Ekonomik.

-Po ashtu edhe te Fasadimi dhe izolimi i banesave konkretisht Blloqet:I, II, III, IV Drejtoria nuk ka Kompetenca pra varet nga Kompania.

-Tek Rruga Asllan Fazliu ,që është theksuar që është pa ndriqim , nëse Kontrata është ende valide atëherë Kompetencat I ka Opertatori Ekonomik për qdo parregullësi që bëhet,nderkaq nga shkeputja e Kontrates atëherë adresohet ne Drejtori.

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2022

Takimi I tretë

Takimi i tretë për vitin 2022 të Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik ,Mbrotje të Mjedisit , Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale (KKZHEMASHMS) ,u mbajt më 13.09.2022.

Në këtë mbledhje morën pjesë anëtarët e komitetit si: Fitore Sefiu Shabani –kryesuese, Burim Dvorani nën kryesues,dhe anëtarët si: Basri Gashani dhe Violeta Ipshi- Bujupi.Të ftuar në këtë takim kemi pasur anëtarët e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuar (KKPAK), anëtarët e Komitetit Konsultativ për Arsim Kulturë Rini dhe Sport (KKAKRS) si dhe anëtarët e Komitetit Konsultativ për Barzi Gjinore (KKBGJ) .

Për takimin tonë është informuar edhe opinion përmes faqes tonë në rrjetin social facebook si dhe është bërë thirrje për pjesëmarrje nga ana e qytetarëve që të jenë të pranishëm në takimin tonë në mënyrë që të adresojnë kërkesat e tyre.Po ashtu kemi ftuar edhe përfaqësues nga Qendra për Promovimin e të Drejtave Të Grave, përfaqësues nga KVRL të cilët munguan në takim si dhe organizata Handikos me përfaqësuese Lendita Elshani.

Temat e diskutimit në këtë takim, ndër të tjerat ishin:


- 1.Procesverwali I dt. 15.06.2022
2. Prezantimet e të arriturave të Komiteteve Konsultative
- 3.Diskutime dhe qështje për KKZHEMASHMS,
- 4.Diskutime dhe qështje për KKPAK,
5. Diskutime dhe qështje përKKAKRS,
6. Diskutime dhe qështje për KKBGJ, dhe
7. Të ndryshme

Në këtë takim u prezantuan punet dhe të arriturat e Komiteteve Konsultative si dhe u shpalos program që do të punohet në të ardhmen.

Qëllimi i këtij takimi ka qenë që të ketë qytetar të pranishëm në mënyrë që ata të njoftohen me funksionimin dhe kompetencat e komiteteve.

Nga ky takim nxorem mundësitë e bashkëpunimit në fushat përkatëse të komiteteve, takime me qytetarë dhe mundësinë e dhënies së rekomandimeve në qështje të caktuara.

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2022



RAPORT VJETOR PËR VITIN 2022

Takimi I katërt

Mbledhja e katërt për vitin 2022 të Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik ,Mbrojtje të Mjedisit , Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale (KKZHEMASHMS) ,u mbajt më 29.11.2022.

Në këtë mbledhje morën pjesë anëtarët e komitetit si: Fitore Sefiu Shabani –kryesuese, Burim Dvorani nën kryesues,dhe anëtarët si: Basri Gashani Arbresha Haziri dhe Violeta Ipshi- Bujupi me të ftuar Shkendie Thaqi –Zyrtare për Mjedis

Për mbledhjen tonë është informuar edhe opinionin përmes faqes tonë në rrjetin social facebook.

Temat e diskutimit në këtë takim janë

- 1.Procesverнали I dt. 15.06.2022
2. Plani zhvillimor për mjedis në Komunen e Drenasit dhe hapsirat e gjetura që janë parapare me këtë plan
- 3.Ankesat dhe kërkesat e qytetarëve sa i përket mjedisit
- 4.Te ndryshme .



RAPORT VJETOR PËR VITIN 2022

Ne këtë mbledhje me Zyrtares për Mjedis diskutuam rreth ketyre çështjeve dhe morem këto informata:

-Pika e pare qe sa i Përket Hapsirave publike dhe te gjelberta Komuna e Drenasit I ka te identifikuar 7 Hapsira Publike qe gjenden ne qytet :

1. Sheshi 'FEHMI LLADROVCI '
2. Parku i qytetit
3. Parku i Komunës së re
4. Parku i Komunes së vjetër
5. Hapsira e gjelberuar te Banesat (tek 5 blloqet)
6. Hapsira e gjelberuar te Çerdhja 'ARDHMERIA'
7. Hapsira e gjelbruar te rruga e zejtareve

-Pika tjeter u informam qe sa i përket projekteve për mjedis është projekti tre vjeçar ku shume e tij eshte 60.000€ ku per çdo vit jane ne shfrytezim nga 20.000€ per mbjellje dhe mirembajtje nga Kompania kontraktuese .

-Po ashtu u tha që ka pas edhe Donacione nga EULEX ,ky fondacion u shfrytezua ne shkolla ku jane mbjell fidane .

-Nderkaq sa i perket ankesave të qytetareve te adresuara per ndotje te mjedisit nga papastertia dhe berllogu , u tha që ka bashkpunim me drejtori te tjera (Drejtoria e Inspeksionit) dhe marrin pastaj masat e nevojshme.

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2022

Takimi I pestë

Mbledhja e pestë për vitin 2022 të Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik ,Mbrojtje të Mjedisit , Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale (KKZHEMASHMS) , u mbajt më 19.12.2022.

Në këtë mbledhje morën pjesë anëtarët e komitetit si: Fitore Sefiu Shabani –kryesuese, Burim Dvorani nën kryesues,dhe anëtarët si: Basri Gashani dhe Violeta Ipshi- Bujupi.Të ftuar në këtë takim kemi pasur te ftuar nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik përkatësish drejtoreshën znj.Egzona Jetullahu Gjoshi.



Për takimin tonë është informuar edhe opinion përmes faqes tonë në rrjetin social facebook si dhe është bërë thirrje për pjesëmarrje nga ana e qytetarëve që të dërgojnë me pyetje qështjet që i'u intereson. Temat e diskutimit në këtë takim, ndër të tjerat ishin:

- 1.Procesvernali I dt. 29.11.2022
2. Prezantimet e të arriturave të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
- 3.Hartimi I planit strategjik për vitin 2023,dhe
4. Të ndryshme

Në këtë takim u prezantuan punët dhe të arriturat e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik si dhe u shpalos program që do të punohet në të ardhmen.

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2022

Këtë vit janë regjistruar 124 biznese e po ashtu ka pas edhe mbyllje të bizneseve. Vlen të theksohet se kjo drejtori I përkrahë grat që qëfillojnë biznese duke I liruar 3 vjet nga taksat komunal.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me shum organizata të huaja si ajo e UNDP, E4E, HELP etj.

Nga drejtoresha u njoftuam se 15% e projekteve të Komunës së Drenasit në bashkëpunim me kryetarin e Komunës realizohen nga kjo drejtori.

Problemi kryesor ne zhvillim e projekteve është buxheti I pakët që miratohet nga Kuvendi I Kosovës.

Poashtu u bisedua edhe për Hartimin e Planet Strategjik për vitin 2023.Me Hartimin e Planit Strategjik dhe Harten Zonale te Komunës së Drenasit dhe për pronat që mund tëjapin në shfrytëzim për bizneset.

Pritet që viti 2023 të vazhdohet me subvencionimin e Start Up Bizneseve në bashkëpunimin me organizatat e huaja dhe nga vet Drejtoria Për Zhvillim Ekonomik.

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2022

Takime joformale

1.Së bashku me anëtarët e komitetit ishim në vizitë në QKMF dr.Harif Shala në Drenas më konkretisht në repartin e radiologjisë ku u pritëm nga dr.Shkelzen Gashi radiolog. Në bisedë e sipër doktor Gashi na e spjegoi një ecuri ne faza për diagnostifikimin e një karcinome të mundshme të gjirit.



2. Në bashkëpunim me Komitetin Konsultativ Për persona me aftësi të Kufizurarkemi lansuar një video informuese me qëllim që t'i kontribuohet ndërgjegjësimit për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Videon e plote mund ta shihni ne faqen facebook te Komitetit ne linkun e mëposhtëm

<https://www.facebook.com/100063576671196/videos/903635354135985>

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2022

Rezultatet dhe përfundimi

Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale trajtuam problemet nga më të ndryshmet me të ftuarit që kishim present në disa nga takimet tona.

Besojmë që takimet tona kanë qenë të frytshme dhe konstruktive duke bërë rekomandime të qastit si dhe duke vënë në pah problemet dhe duke qasur problemeve në një kënd tjetër vështrimi, atë të qytetarit.

Vlenë të theksohet se thirrjeve tona për takime u janë përgjigjur pozitivisht të gjithë të ftuarit.

Problemet që trajtoi Komiteti jonë kanë qenë kryesisht nga fusha e mjedisit, shëndetësia, mirëqenia sociale dhe zhvillimi ekonomik.

Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Mjedisit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale punon në drejtimin që qytetarit t'i ndëgjoet zëri edhe kur ai nuk është i pranishëm, të informohet qytetari me të gjitha ngjarjet që e karakterizojnë qytetin e tij, të informohet për të gjitha thirrje që bëhen nga Drejtoritë Komunale për dhënien e subvencioneve, bursave për student etj.

Vlen të theksohet se komiteti joë ka një bashkpunim të mirëfillt me të gjitha drejtoritë komunale e sidomos asaj të Inspekcionit dhe Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Emergjete, duke raportuar raste të hudhjes së mbeturinave në vende joadekuate e duke krijuar depotë egra.

Komiteti jonë do të vazhdojë në drejtimin e dëgjimit të zërit të qytetarit duke u dhënë mundësi të jënë më afër vendimmarrjeve.

Të gjitha aktivitetet tona mund ti shihni në linkun e mëposhtëm:

www.facebook.com/Komiteti-Konsultativ-per-Mb-te-Ambientit-Shendetesi-dhe-MSocial



Fitore Sefiu Shabani
Kryesuese e komitetit